



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Doretuar Priljenor/Prodato Received/Delivery	27-12-2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot.No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIPSHICK	7688/2023		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1406/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani -kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1406/2023 të datës 13.11.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë rr. Mat Komuna e Prishtinës, kundër Vendimit me numër DM 721/2023 të datës 13.10.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "Transferim për shkak të ristrukturimit", në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 27.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1406/2023 e datës 13.11.2023 e parashtruar nga ankuesi**
- II. Shfuqizohet Vendimi me numër DM 721/2023 i datës 13.10.2023 i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.**
- III. Obligohet Drejtori Ekzekutiv i Agjencinë Kosovare të Privatizimit që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e këtij vendimi, duke marr parasysh pikëpamjet e dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.**
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.**

Arsyetim

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 30.11.2022, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.09.2023, ka nxjerr Vendim me të cilin ka aprovuar Rregulloren Nr. 05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me arsyetimin se është konstatuar nga Bordi se Rregullorja aktuale ka nevojë për rishikime/përmirësime. Sipas Rregullores Nr. 05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, konkretisht sipas nenit 43 është shfuqizuar Rregullorja Nr. 07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa sipas vendimit të lartcekur kjo rregullore hyn në fuqi nga data 01.10.2023.

Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit më datë 29.08.2023 ka nxjerr Vendimin DM 653/2023 për themelimin e Komisionit të Ristrukturimit, ndërsa sipas Vendimit me numër DM 666/2023 të datës 07.09.2023 është amandamentuar Vendimin DM 653/2023 kështu që Komisionit të Ristrukturimit i vazhdohet afati i punës për tridhjetë (30) ditë nga data e nxjerrjes së këtij vendimi, kjo është bërë me arsyetimin se është miratuar Rregullorja Nr. 05/2023 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit lidhur me pozitën e lirë të Drejtorit të Departamentit të Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes ka nxjerr Raportin e Punës 05/2023 dhe Raporti e Punës 06/2023.

Në bazë të Raportit të Punës 05/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes", ka shqyrtuar aplikacionet e katër (4) kandidatëve, duke konstatuar se të gjithë plotësojnë kriteret për këtë pozitë, mirëpo që sipas poentimit kandidatët janë renditur si më poshtë: kandidati me inicialet A.F. është vlerësuar me gjithsej 35.5 pikë, kandidati me inicialet R.Z. është vlerësuar me gjithsej 34 pikë, kandidatit me inicialet M.A. është vlerësuar me gjithsej 33.5 pikë, kandidati me inicialet L.G. është vlerësuar me gjithsej 31.5 pikë. Në bazë të këtij raporti kandidati me më së shumti pikë është vlerësuar ankuesi A. F. me gjithsej 35.5. pikë.

Ankuesi M. A. me datë 20.06.2023 dhe ankuesi R. Z. me datë 19.06.2023 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër vendimit DM194 të datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe kundër vendimit DM193 të datës 23.05.2023 të Drejtorit të Departamentit të Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerrë vendim me numër protokollit 5702/2023 me datë 17.08.2023 me të cilin ka anuluar Raportin e punës 05/2023 të

Komisionit të Ristrukturimit lidhur me procedurën e transferimit në pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes" vendimi DM194 i datës 23.05.2023 dhe vendimi DM193 të datës 23.05.2023 të nxjerra nga Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore i Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Agjencia Kosovare e Privatizimit duke vepruar në bazë të Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.08.2023, ka rishqyrtuar lëndën dhe ka nxjerr Raportin e Punës Nr.06/2023 me datë 12.09.2023.

Ndërsa në bazë të Raportit të Punës 06/2023, Komisioni i Ristrukturimit i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes", ka shqyrtuar aplikacionet e katër (4) kandidatëve, duke konstatuar se të gjithë plotësojnë kriteret për këtë pozitë, mirëpo që sipas poentimit kandidatët janë renditur si më poshtë: kandidati me inicialet M.A. është vlerësuar me gjithsej 54 pikë, kandidati me inicialet R.Z. është vlerësuar me gjithsej 52.75 pikë, kandidati me inicialet A.F. është vlerësuar me gjithsej 40.25 pikë, kandidati me inicialet L.G. është vlerësuar me gjithsej 35.25 pikë, duke propozuar që sipas këtij poentimi kandidati me inicialet M.A. të transferohet në pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes". Ndërsa kandidati _____ si sipas Vendimit me numër DM 721/2023 të datës 13.10.2023 nuk kualifikohet për pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes".

Bazuar në raportet e cekura si më lartë, kandidatët që nuk kanë arritur të transferohen në këtë pozitë janë nxjerr aktet administrative nga Drejtori i Burimeve Njerëzore i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ku sipas Vendimit për plotësim ndryshim të vendimit DM678/2023 për moskualifikim të nëpunësit _____ për pozitën "Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes" ka nxjerr vendim me numër DM 721/2023 të datës 13.10.2023 ku nëpunës. _____ nga data 01.10.2023 do të vendoset në listën e pritjes.

Ankuesi kundër Vendimit me numër DM 721/2023 të datës 13.10.2023 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, më datë 13.11.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 6965/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve esenciale materiale dhe procedurale të dispozitave të ligjit të aplikueshëm.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 30.11.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ndërsa Këshilli më datë 07.12.2023 ka pranuar përgjigje në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 6965/2023 të datës 13.11.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM678/2023 i datës 15.09.2023; Vendim i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me numër DM721/2023 i datës 13.10.2023; E-mail i datës 02.10.2023; E-mail nga Burimet Njerëzore për L.G. i datës 29.09.2023; E-mail i datës 23.05.2023; E-mail nga Burimet Njerëzore për L.G. i datës

23.05.2023; E-mail i datës 08.05.2023; E-mail i datës 18.01.2023; E-mail nga Burimet Njerëzore për K.B. i datës 13.02.2023; E-mail i datës 20.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 30.11.2023; Përgjigje në ankesë e datës 07.12.2023; Vendim me numër Nr.Ref.BD-173/3 i datës 30.11.2022; E-mail nga PAK INFO për PAK ALL i datës 06.12.2022; Akt Emërim i L.G. i datës 30.12.2022; Përshkrimi i punës i datës 06.03.2019; Vendim për themelim të komisionit ristrukturimit me numër DM1118/2022 i datës 14.12.2022; Vendim me numër DM37/2023 i datës 14.02.2023; Vendim për themelim të komisionit ristrukturimit me numër DM184/2023 i datës 12.05.2023; E-mail nga PAK INFO për PAK ALL i datës 22.12.2022; E-mail nga L.Xh.T. për L.G. i datës 23.12.2022; E-mail nga L.G. për A.L.G. etj. i datës 19.01.2023; Vendim me numër DM27/2023 i datës 06.02.2023; Përshkrimi i punës i datës 06.02.2023; E-mail nga Burimet Njerëzore për K.B. etj. i datës 13.02.2023; Vendim me numër Nr.Ref.BD-176/2 i datës 14.02.2023; E-mail nga PAK INFO për PAK ALL i datës 15.03.2023; Konkurs lëvizje brenda kategorisë në AKP për pozitën *'Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes'* i datës 15.03.2023; Raport Pune 05/2023 i AKP; Akt Emërim i M.A. i datës 26.12.2012; Akt Emërim i M.A. i datës 05.08.2014; Akt Emërim i M.A. i datës 29.12.2022; Akt Emërim i L.G. i datës 27.12.2012; Akt Emërim i L.G. i datës 01.08.2014; Akt Emërim i L.G. i datës 24.08.2017; Akt Emërim i L.G. i datës 11.09.2018; Akt Emërim i L.G. i datës 30.12.2022; Propozim me numër Nr.KR/23/2023 i datës 22.05.2023; Vendim me numër Nr.Ref.BD-186/39 i datës 04.09.2023; Vendim për themelim të komisionit ristrukturimit me numër DM653/2023 i datës 29.08.2023; Raport Pune 06/2023 i AKP; Propozim me numër Nr.KR/27/2023 i datës 12.09.2023; Kolegji nuk ka trajtuar provat tjera të bashkëngjitura për shkak se vendimi ka pasur të meta të tilla që nuk ka mundur të shqyrtohet.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e bazuar, *sepse*:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndëve të tjera në procedurë të shqyrtimit ka gjetur se për të njëjtën procedurë të transferimit së cilës ju ka nënshtruar ankuesi, konkretisht për pozitën *'Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes'* sipas Raportit të Punës 05/2023 dhe sipas Raportit të Punës 06/2023 të nxjerra nga Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së, ka pasur të parashtruara edhe ankesë tjetër sipas së cilës janë kundërshtuar aktet, respektivisht procedura e zhvilluar e transferimit si dhe vendimet që kanë derivuar prej tyre lidhur me transferimin apo sistemimin e palëve në procedurë.

Andaj, sikurse u theksua më lartë, Këshilli me datë 12.10.2023 ka pranuar ankesën e parashtruar nga ankuesi A.F. i cili ka kontestuar procedurën e zhvilluar të transferimit që ndërlidhet me pozitën *'Drejtor i Departamentit të Realizimit dhe Aseteve dhe Shpërndarjes'*, sipas Raportit e Punës 05/2023 dhe 06/2023 të nxjerra nga Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së, ndërsa pas analizimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të procedurës së zhvilluar të transferimit rreth poentimit të kandidatëve, dhe zbatimit të ligjit material, Këshilli me datë 11.12.2023 ka nxjerrë Vendimin A.nr.1278/2023 përmes të cilit ka anuluar Raportin e Punës 05/2023 dhe 06/2023 të nxjerra nga Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së si dhe vendimin përmes së cilës kandidati i suksesshëm është sistemuar në pozitën respektive, për shkak se Kolegji i Këshilli ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka shqyrtuar drejtë faktet dhe dosjet e kandidatëve, kështu që në këtë rast raportet i ka përgatitur në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në kundërshtim me frymën e

dispozitive të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë që rregullon parimet e përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë, referencat që kanë të bëjnë me transferimin e nëpunësve civil si rezultat i ristrukturimit, dispozitive të nenit 14 paragrafi 5 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, i cili përcakton se: “Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kritere: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë. 5.4. trajnimet”, si dhe hapave të përcaktuara përmes Udhëzuesit Nr. 02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimit të Nëpunësve pas Ristrukturimit, kështu që këto raporte janë të paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin që ankesa e ankuesit është bazuar dhe e njëjta është aprovuar, kurse për shkak të shkeljeve të përcaktuara si më lartë nga ana e Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi akti i kontestuar, gjegjësisht Vendimi me numër DM 721/2023 i datës 13.10.2023 i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kurse sipas Vendimit të Këshillit A.nr.1278/2023 të datës 11.12.2023 është anuluar Raporti i Punës 05/2023 dhe Raporti i Punës 06/2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa lënda është kthyer në *rishqyrtim* në Komisionin e Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, nga rrjedh se me rastin e rishqyrtimit të lëndës në tërësi, të njëjtit proces do t'i nënshtrohet edhe ankuesi, andaj mbi këtë bazë meqenëse në vendimin e Këshillit A.nr.1278/2023 është trajtuar procesi në tërësi që ndërlihet edhe me Raportin e Punës 05/2023 dhe Raportin e Punës 06/2023 dhe se të njëjtat janë anuluar, kështu që nuk ka qenë e nevojshme si çështje e vendosur meritorisht të shqyrtohet edhe përmes këtij vendimi.

Po ashtu, lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar me ankesë konkretisht Vendimit me numër DM 721/2023 të datës 13.10.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Këshillit me qëllim të mos dëmtimit të palëve në procedurë, konstaton se procesi i ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit ka filluar në kohën kur në fuqi ka qenë Ligji Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe i njëjti aplikohen në këtë procedurë deri në bërjen e aktit administrativ përfundimtar, mirëpo Departamenti i Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit vendimin e kundërshtuar me ankesë e ka nxjerr duke ju referuar dispozitive të nenit 66 dhe 67 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, kurse Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë në asnjë dispozitë ligjore nuk vepron në mënyrë retroaktive përveç rasteve të parashikuara me dispozitat kalimtare gjegjësisht me nenin 99 të këtij ligji. Bazuar në këtë, Kolegji i Këshillit, konstaton se procesi i ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit nuk ka filluar sipas dispozitive të nenit 66 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, por ky proces ka filluar sipas nenin 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që në këtë procedurë nuk mund të aplikohet neni 67 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ngase ky nen aplikohet vetëm nëse procesi i ristrukturimit ka filluar sipas nenit 66 të këtij ligji, rrjedhimisht në këtë rast nuk mund të aplikohet lista e pritjes, siç është vendosur me vendimin e kundërshtuar me ankesë, kështu që Kolegji i Këshillit, konstaton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji, ngase me këtë vendim janë shkelur parimet e ligjit material respektivisht parimet e

përgjithshme të menaxhimit të zyrtarëve publikë të përcaktuar me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, kështu që pretendimet e ankuesit ndaj këtij vendimi janë të bazuara.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1406/2023.

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së